

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, sipas gjykatësës së vetme gjykuese, Luljete Shabani, me praktikanten e kësaj gjykate, Albana Islami, në lëndën penale të të akuzuarit L H, nga Gj, ku edhe jeton, për shkak të veprës penale, Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378, par. 6, lidhur me par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore, Departamenti i Përgjithshëm Penal në Gjilan, PP. II. nr. 1800/2015, e datës 27.03.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, më datë 06.04.2017, në prezencë të palëve, mori dhe publikisht shpalli, dhe më datë 20.04.2017, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari L. H, nga babai E. dhe nëna N, e lindur R, i lindur më datë në Gj, ku edhe jeton, i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i padënuar më parë, dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij,

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse, më datë 21.02.2015, rreth orës 16:00, në rr. “....., ka shkelur paragrafin 151.2 lidhur me paragrafin 151.1, të nenit 151 të LSKRR dhe ka rrezikuar pasurinë dhe jetën e njerëzve, ashtu që duke drejtuar automjetin e markës “”, me ngjyrë hiri dhe me targë të regjistrimit 06-714-BB, nuk iu është përmbajtur dispozitave të Ligjit në fjalë që kanë të bëjnë me obligimin e shoferit që gjatë kalimit të trotuarit apo shtegut të këmbësorve duhet të ngas ngadalë automjetin, dhe t’iu jap përparsi këmbësorve në sheshe, lehtë ka menduar se edhe për kundër kësaj nuk do të shkaktojë pasojë të ndaluar, ashtu që me të arritur në vendin e përmendur me kohë nuk e vren këmbësorin – tani të dëmtuarin....., nga fshati V. e epërme të, i cili ishte duke e kaluar rrugën në vendkalimin e shënuar për këmbësorë dhe për pasojë, me pjesën e përparme të anës së djathë të automjetit e godet të dëmtuarin dhe me këtë rast të njëjtit i shkakton lëndime të lehta trupore në formë të ndrydhjeve (mbetjeve) të indeve të buta të regjionit iJOR (lombal), të regjionit të villës (mullaqës) së djathë, të kofshës së këmbës së djathtë dhe faqeve të sipërme të gishtërinjve të të dy shpatullave të këmbëve, me pasoja të përkohshme për shëndetin,

- me çka ka kryer veprën penale, **Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378, par. 6, lidhur me par.1 të KPRK-së**, andaj, bazuar dispozitat e neneve 7,17,21,51,69, 73,114,të KPRK-ës, dhe nenit 365, 453 të KPPRK-së, gjykata,

E G J Y K O N

Të akuzuarin L. H, me Dënim me Gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilën gjobë i akuzuari do ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën Gjykata dënimin me gjobë do të ia zëvendësoj me dënim burgu, ashtu që do t’i llogaritet shuma prej 20€ për një ditë burgimi.

Obligohet i akuzuari që t’i paguaj shpenzimet e procedurës penale, dhe paushallin gjyqësor në lartësi prej 20 (njëzetë)€, e gjithë këtë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore, Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, ka paraqitur aktakuzën PP. nr. 260/2015, të datës 27.03.2015, kundër të akuzuarit L. H, për shkak të veprës penale, Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378, par. 6, lidhur me par. 1 të KPRK-së dhe ka kërkuar që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

Prokurorja e shtetit Huma Jetishi, në fund të procedurës deklaroi se në shqyrtimin fillestar, i akuzuarie pranoi fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës lëndore. I akuzuari fajësinë e pranoi me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë, pasi që nga gjykata u njoftua lidhur me favorët dhe pasojat e pranimit të fajësisë. Kështu që me pranimin e fajësisë rezultoi se u vërtetua në tërësi gjendja faktike ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës. Prokurorja deklaroi se mbetet pranë aktakuzës dhe propozimeve të cilat e njëjta i përmban, dhe kërkon nga gjykata që të akuzuarinta shpall fajtor dhe t'ia shqiptojë sanksionin e paraparë ligjor, mirëpo para se të përcaktohet për llojin dhe lartësinë e dënimit të marrë parasysht si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pendimin e tij, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, ndërsa si rrethanë rënduese shkallën e përgjegjësisë penale dhe lëndimet e shaktuara të dëmtuarit, e pastaj të akuzuarit t'ia shqiptojë sanksionin e paraparë ligjor, në mënyrë që me shqiptimin e sanksionit adekuat të arrihet qëllimi i dënimit.

I akuzuari L. Hi, në fjalën përfundimtare deklaroi se është penduar, se i vjen keq për këtë veprë penale, premtoi se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm në komunikacion, andaj kërkoi nga gjykata që t'ia shqiptojë një dënim sa më të butë që është e mundur.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit erdhi në përfundim se i akuzuari L.H e ka kryer veprën penale, Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378, par. 6, lidhur me par.1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysht rrethanat e parapara me nenin 73 të KPK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, pati sjellje të mira në Gjykatë, premtimin e tij se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm në komunikacion dhe nuk do të kryej vepra penale, ndërsa, si rrethanë rënduese, pati parasysht rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe faktin se këto vepra janë dukuri mjaft e shpeshtë, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit, në kuptim të nenit 41 të KPK-ës.

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.
Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P. nr. 335/15, më datë 20.04.2017**

**Praktikantja,
Albana Islami**

**Gjykatësja e vetme gjykuese,
Luljete Shabani**

KËSHILLA JURIDIKE: *Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.*